



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 221, datë 28.12.2017

PËR

**MIRATIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË SË
SIGURIMIT “EUROSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, me propozim të Zyrës së Licencimit, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e riemërimit të z. Vasil Pilo, në funksionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës së shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a., për një afat 3 (tre) vjeçar, nga data 25.11.2017, deri në datë 24.11.2020.
2. Miratimin e riemërimit të z. Rexhep Meidani, në funksionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës së shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a., për një afat 3 (tre) vjeçar, nga data 25.11.2017, deri në datë 24.11.2020.
3. Miratimin e riemërimit të z. Skënder Madani, në funksionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës së shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a., për një afat 3 (tre) vjeçar, nga data 25.11.2017, deri në datë 24.11.2020.
4. Ngarkohet Zyra e Licencimit, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI